



BARABAR PARIMET

Për besim dhe pajtim në Kosovë

mbështetur nga
UNMIK

 **Barabar**
CENTRE




BARABAR PARIMET

Për besim dhe pajtim në Kosovë

Parathënie:

E përdorur në të dyja gjuhët zyrtare në Kosovë, shqip dhe serbisht, fjala barabar do të thotë barazi dhe drejtësi. Të frymëzuara nga kjo dhe të harmonizuara me pikëpamjet dhe opinionet e akterëve të shumtë anembanë Kosovës, BARABAR PARIMET kanë për qëllim të forcojnë lidhjet e bazuara në atë që i bashkon dhe jo në atë që i ndan komunitetet e ndryshme, në mënyrë që të avancojmë dialogun, të promovojmë tolerancën dhe bashkëpunimin, ndërtimin e besimit dhe arritjen e drejtësisë. Parimet konfirmojnë se përmirësimi i marrëdhënieve mes komuniteteve është kyç për arritjen e pajtimit, të paqes së qëndrueshme dhe zhvillimit në Kosovë. Ato gjithashtu njohin se secili individ, pavarësisht nga përkatësia etnike, mosha, gjinia, feja, aftësitë, orientimi seksual, statusi social ose ekonomik ose ndonjë veçori tjetër, duhet të jenë në gjendje të ushtrojnë lirshëm të drejtat e tyre, të shprehin pikëpamjet e tyre përmes zgjedhjes, të marrin pjesë aktive në aktivitetet shoqërore dhe të ruajnë vlerat e tyre.¹

¹*Qendra Barabar është një nismë e përbashkët e organizatave të shoqërisë civile INTEGRA nga Prishtina, dhe CASA nga Mitrovica e Veriut. Me seli në Prishtinë, ajo ka për qëllim të fokusohet në zhvillimin e besimit dhe dialogut të hapur gjithëpërfshirës ndërmjet të gjithë anëtarëve të shoqërisë së larmishme multi-etnike të Kosovës, përmes informimit kulturor, artistik, publik, ngritjes së kapaciteteve, edukimit, ngritjes së vetëdijes dhe avokimit. Qendra Barabar do të ndërtohet duke u bazuar në përpjekjet e iniciativave të mëparshme (Forumi dhe Platforma për Ndërtimin e Besimit, Koalicioni për Pajtimit, Koalicioni për Parimet për Ballafaqim me të Kaluarën, Projekti për Inkurajimin e Bashkëpunimit Ndëretnik dhe Pajtimit) dhe iniciativa tjera të shumta që kanë pasur për qëllim dialogun mes komuniteteve të cilat janë zhvilluar gjatë dy dekadave të fundit në Kosovë. Qendra Barabar nuk është parashkuar si projekt apo platformë e organizatave apo individëve, por si një hapësirë e përhershme e sigurt që shërben si kanal i hapur komunikimi dhe i shprehjes së ideve për të gjitha komunitetet në Kosovë.



01. Ndërtimi i besimit dhe pajtimit është një proces i ngadalshëm. Së pari duhet të mësojmë për njëri-tjetrin nëse duam të angazhohemi vërtet.

Çka:

Besimi është në thelb të procesit të ndërtimit të paqes dhe pajtimit. Njerëzit nga komunitetet e ndryshme në Kosovë e ndajnë hapësirën e jetesës, por kanë ndërveprim dhe kontakt të kufizuar. Besimi duhet mësuar dhe fituar ngadalë. Sa më shumë të mësoni për njerëzit, aq më shumë do të jeni në gjendje të lidheni me ta, ta gjeni gjuhën e përbashkët dhe të lini mënjanë dallimet. Nëse komunitetet shpresojnë për pajtim, ato duhet së pari të ekspozohen ndaj njëri-tjetrit, ndaj kulturës, traditës, fesë, gjuhës, vlerave dhe interesave të njëri-tjetrit, të cilat të gjitha janë pararendëse për ndërtimin e mirëkuptimit dhe të ndjeshmërisë.



Si:

Ne duhet të sigurojmë që lidhjet tashmë ekzistuese individuale të zhvillohen në ndërveprime grupore - për të vlerësuar më mirë komunitetet e ndërsjella, të ndërtojmë respekt, dhe kënaqemi me kulturat dhe traditat e ndryshme, duke i'u përshtatur diversitetit. Besimi nuk është diçka që arrihetqë shpejtë e që do të ndodhë nesër, por në afat të gjatë ka potencial për të shpëtuar brezat e ardhshëm nga konflikti dhe nga jetuaritqë ende vazhdon të jetë i ndarë sipas vijave etnike.

et

01



02. Duhet ta vendosim komunikimin e ndërsjellë ndërmjet pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme etnike.

Çka:

Njerëzit nga të gjitha komunitetet duhet të jenë në gjendje të ndërveprojnë dhe të flasin me njëri-tjetrin pa frikë. Frika i degradon proceset e krijimit të besimit dhe të pajtimit, duke e minuar parimin bazë të një ndërveprimi të tillë: motivimin. Në Kosovë, ekziston ende një besim shoqëror që nuk është gjithëpërfshirës, sipas të cilit njerëzit besojnë në bazë të kufijve të paracaktuar politik/etnik. Duke përgjithësuar ndarjen “ata dhe ne”, njerëzit duket se ndihen të sigurt vetëm mes anëtarëve të komuniteteve të tyre.



Si:

Ne duhet të krijojmë një mjedis ku besimi mund të arrihet përmes komunikimit të hapur. Ne duhet të lehtësojmë rrjetet shoqërore të besimit jo vetëm nëpërmjet politikave, por edhe nëpërmjet praktikave brenda shoqërisë civile, të lira dhe të pavarura nga ngjarjet politike. Në këtë rast, disponueshmëria e një hapësire të përhershme për ndërtimin e besimit, një hapësirë për shoqërim dhe bisedë të lirë pa kufizime apo autocensurë, do të ndihmojë në kapërcimin e paragjyqimeve. Ne duhet të krijojmë mekanizma për ta lehtësuar vazhdimin e marrëdhënieve paqësore ndërmjet komuniteteve dhe për të zhvilluar një mjedis të sigurt për bashkëpunim dhe integrim. Ndërveprimi çon në të kuptuarit e të tjerëve, gjë që mund të lehtësojë përfundimisht fazat e ardhshme të procesit të normalizimit/paqes, kur njerëzit mësojnë të jetojnë së bashku, duke pranuar dhe respektuar dallimet.

net

02



03. Duhet t'i njohim, t'u përshtatemi dhe t'i vlerësojmë veçoritë dalluese ndërmjet komuniteteve etnike.

Çka:

Pajtimi në Kosovë nënkupton përshtatje dhe dallimet duhet të respektohen. Ne duhet ta parandalojmë kategorizimin dhe stereotipet në mënyrë që të ndryshojmë perceptimin e përgjithshëm për të tjerët. Qëllimi mund të jetë që, dikur në të ardhmen, të gjithë t'i përkasin të njëjtës shoqëri kosovare, pa e humbur identitetin e tyre personal në komunitet. Kjo e kërkon përshtatjen e të gjithëve dhe jo asimilimin e një komuniteti në një tjetër. Uniteti nuk është domosdoshmërisht i nevojshëm, por duhet të ketë hapësirë që të gjitha komunitetet të ndihen rehat, të respektojnë ekzistencën e njëri-tjetrit dhe ndjenjën e përkatësisë. Të menduarit për tjetrin duhet të jetë në qendër të përpjekjeve për krijimin e besimit dhe arritjen e pajtimit.

perim



Si:

Të gjitha palët do të duhet të angazhohen në mënyrë të barabartë në procesin e pajtimit. Ata që i përkasin shumicës kanë një detyrë shtesë për të pranuar dhe avokuar për komunitetet joshumicë, kudo që gjenden dhe në çdo pikë gjeografike të cilës i përkasin. Komuniteti i shqiptarëve të Kosovës, veçanërisht shoqëria civile e komunitetit shumicë, duhet t'i shtojë përpjekjet për t'iu qasur komuniteteve joshumicë dhe për t'i pranuar ata pa kushte, duke i pranuar dallimet, duke hedhur poshtë stereotipet dhe duke synuar kohezionin social në një shoqëri ku të gjithë mund të ndihen të sigurt dhe të pranuar. Po ashtu, komuniteti i serbëve të Kosovës duhet t'i pranojë dhe të punojë me komunitetet tjera në komuna ku ata janë shumicë, të angazhohet dhe të bëjë përpjekje për t'i kuptuar ata dhe të kontribuojë në mirëqenien e përbashkët.

net

03



04. Duhet t'i identifikojmë dhe t'i kultivojmë interesat dhe vlerat e përbashkëta ndërmjet komuniteteve të ndryshme etnike.

Çka:

Komunitetet në Kosovë duhet të jenë në gjendje të bien dakord për besimet dhe vlerat e përbashkëta, dhe të bashkohen së paku prapa një grup synimesh të përbashkëta. Ne duhet t'i ndihmojmë komunitetet ta gjejnë motivimin e nevojshëm për t'i kapërcyer dallimet dhe për të gjetur këto veçori të përbashkëta. Në botën e globalizimit, izolimi nuk është një opsion. Ka sfida dhe mundësi të përbashkëta që prekin komunitetet, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në: punësimin (mundësi për të gjithë), pagat, arsimin (hendek në digjitalizim), qasjen në kulturë, art, muzikë, rini (perspektiva të reja), sigurinë në trafik, mirëqenien shoqërore (pabarazitë, kujdesi për të moshuarit dhe invalidët), mirëqenien e fëmijëve, mbështetja psiko-sociale për viktimat, shëndetin (sëmundjet mendore, të drejtat riprodhuese të grave, qasja në kujdes shëndetësor cilësor), nevojën për integritet, nevojën për drejtësi.

perim



Si:

Ne duhet t'i identifikojmë këto çështje të përbashkëta, të kemi vullnet të diskutojmë për to dhe, përfundimisht, t'i zgjidhim ato, nëpërmjet një qasjeje bashkëpunuese brenda komuniteteve, pavarësisht nëse kjo përfshin bashkimin rreth një vizioni të përbashkët apo edhe mospajtime konstruktive.

net

04



05. Duhet të fillojmë me përpjekje individuale – qasja e pajtimit nga themeli është e mundur.

Çka:

Ne duhet t'i mbrojmë proceset në nivel lokal, në mënyrë që ato të mos ngecin ose të neglizhohen për shkak të mungesës së progresit në nivel politik. Pajtimi nuk mund të presë zhvillimin e proceseve politike. Fuqia e iniciativave individuale dhe sociale nuk duhet të nënvlerësohet.




Si:

Ne duhet, në nivel individual dhe kolektiv, të jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë tonë, por edhe përgjegjësinë dhe rëndësinë e veprimeve tona. Shikuar nga poshtë lart, procesi do të kalojë nga pajtimi individual (bazik) në pajtimin e komunitetit (udhëheqësit e nivelit të mesëm/krijuesit e opinionit) të pajtimi politik (udhëheqësit). Në këtë rast, shoqëria civile e organizuar nga të gjitha komunitetet duhet t'i iniciojë ndryshimet dhe të ecë përpara në nivel të komunitetit, duke e promovuar bashkëpunimin mes komuniteteve, duke u ofruar hapësirë atyre në terren dhe duke lejuar që zëri i tyre të arrijë tek ata që janë në pushtet. Kur të fillojë të funksionojë pajtimi në nivel lokal, politikanët do të obligohen t'i dëgjojnë.

net

05



06. Duhet ta sigurojmë zbatimin efektiv të sistemit ekzistues të garancive për të drejtat e të gjitha komuniteteve.

Çka:

Parimet mbështetëse dhe një kornizë ligjore që i njeh të drejtat e të gjitha komuniteteve etnike janë parakushte për realizimin e plotë të të drejtave. Dominimi i shtetit të së drejtës, veçanërisht zbatimi i ligjeve që i garantojnë të drejtat e komuniteteve joshumicë, duhet të ecë paralelisht me përpjekjet më të gjera të besimit dhe pajtimit.

perim

Si:

Kosova gëzon një sistem të avancuar të garancive për mbrojtjen e të drejtave të pakicave, me mekanizma dhe garanci institucionale që, ndër të tjera, sigurojnë përfaqësim dhe status të barabartë për të gjitha grupet. Kosova gjithashtu ka ligje dhe politika kundër diskriminimit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane. Këto përfshijnë të drejtat për fenë, gëzimin e trashëgimisë kulturore, përfaqësimin e drejtë në institucione, të drejtën e pronës, të drejtën e përdorimit të gjuhës amtare, qasjen në informacion, qasjen adekuate në të gjitha shërbimet, duke përfshirë posedimin e dokumenteve zyrtare ose të drejtën për ta regjistruar gjendjen civile. Të gjitha këto të drejtat janë të njohura në Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Zbatimi i keq i përhapur gjërësisht i ligjit zhvillohet në praktika diskriminuese dhe kontribuon negativisht në besimin ndërmjet komuniteteve, duke zgjeruar hendekun mes tyre. Moszbatimi i ligjeve mund të jetë pengesë për integrimin ndërmjet komuniteteve. Kjo është veçanërisht e vërtetë për të gjitha grupet e nënperfaqësuara duke përfshirë romët, ashkalitë, egjiptianët, boshnjakët, goranët dhe turqit. Në këtë kuptim, duhet të kërkojmë përgjegjësi nga institucionet qendrore dhe komunale që nuk i përmbahen këtyre rregulloreve.

net

06



07. Duhet të sigurojmë që proceset e ndërtimit të besimit dhe të pajtimit të jenë gjithëpërfshirëse.

Çka:

Pajtimi nuk mund të arrihet pa përfshirjen dhe angazhimin e të gjitha komuniteteve. Bashkëpunimi ndëretnik dhe proceset e pajtimit gjithëpërfshirës duhet të zhvillohen paralelisht me një proces zhvillimi gjithëpërfshirës që mund të arrihet përmes progresit ekonomik dhe kohezionit social drejt paqes së qëndrueshme.



Si:

Duke adoptuar një qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe të ndjeshme ndaj gjinisë, ne duhet të sigurojmë që çdo individ, pavarësisht nga përkatësia etnike, mosha, gjinia, feja, aftësitë, orientimi seksual, statusi social ose ekonomik ose ndonjë veçori tjetër, mund të kontribuojë në proces dhe zëri i tyre duhet të dëgjohet. Ne duhet të krijojmë rrjete dhe aleanca të ndryshme midis grupeve të synuara, midis komuniteteve të grave, të rinjve, artistëve, biznesmenëve, fermerëve, akterëve të kulturës, viktimave, etj. për të arritur tek vendimmarrësit. Në lidhje me këtë, ne duhet të sigurohemi që pikëpamjet dhe interesat e tyre të përfaqësohen në të gjitha nivelet ku merren vendimet. Kjo qasje e bazuar në të drejtat e njeriut dhe barazinë gjinore është e rëndësishme, jo vetëm për drejtësinë e saj, por edhe sepse do të kontribuojë në efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e procesit, pasi secili mund të ofrojë këndvështrime të ndryshme të dobishme.

net

07



**08. Duhet t'u kërkojmë
përgjegjësi figurave
publike për të siguruar
që narrativat e tyre të jenë
të **vërteta** dhe respektuese,
jo të nxitura nga konflikti
apo përçarja.**

Çka:

I ftojmë figurat publike në Kosovë që të kontribuojnë në pajtim, e jo të promovojnë narrative të nxitura nga konflikti. Politikanët, krijuesit e opinionit, përfaqësuesit e mediave, organizatat e shoqërisë civile, udhëheqësit fetarë dhe përfaqësuesit e komuniteteve duhet të kontribuojnë në përafrimin e qëndrimeve në vend që t'i forcojnë dallimet.

perim



Si:

Raportimi nuk duhet domosdoshmërisht të synojë një qëndrim të përbashkët për të gjithë dhe gjithçka, por duhet të sigurohemi që ai të jetë etik dhe i bazuar në fakte. Në këtë drejtim, ndërsa të gjithë me ndikim në shoqëri duhet të bëjnë përpjekje për të minimizuar pabarazitë, pajtimi politik duhet të diferencohet gjithashtu nga pajtimi shoqëror. Diskurset e polarizuara nuk shërojnë plagët, por i përkeqësojnë ndarjet dhe kontribuojnë në zhvillimin e një ndjenje ekskluzive të komunitetit bazuar në nevojën për të qenë të ndarë dhe për t'i besuar vetëm komunitetit të cilit i përket, për të mundësuar sigurinë bazë. Përpjekjet për ta ndërtuar besimin dhe pajtimin nuk do duhej t'i përngjanin vendimeve politike, por është fakt se ato ndikohen nga mesazhet dhe retorikat përçarëse. Njerëzit janë të pambrojtur ndaj mesazheve të pushtetarëve, të cilët flasin në emër të tyre, ndaj kanë të drejtë në qasje në informacionin e vërtetë dhe të mos manipulohen. Ne duhet të sigurojmë një mjedis në të cilin mediet dhe shoqëria civile mund ta ushtrojnë lirinë e tyre të shprehjes dhe ta kundërshtojnë dezinformimin e përhapur gjerësisht dhe t'i mbajmë institucionet përgjegjëse.

net

08



09. Duhet të bëjmë thirrje për drejtësi për të gjitha viktimat pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike.

Çka:

Viktimat janë viktime. Asnjë viktimë, apo familja e një viktime apo e personit të zhdukur, nuk duhet të kategorizohet apo dallohet nga një tjetër. Nuk do të ketë atribuem kolektiv të krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë, por një thirrje ndërkomunitare për drejtësi për të gjitha viktimat e luftës dhe për zbardhjen e fatit të të gjithë personave të zhdukur, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike.

perim



Si:

Duke njohur përgjegjësinë e institucioneve publike për t'i adresuar shkaqet rrënjësore të konfliktit, për ta siguruar drejtësinë dhe për të pranuar përgjegjësinë nëse janë fajtorë, ne duhet të sigurojmë që proceset e ndërtimit të besimit dhe pajtimit të mos përfshihen në atribuimin e fajit kolektiv ose të pengohen nga narrativa përçarëse.. Puna jonë duhet të jetë e ndjeshme ndaj viktimave, duke theksuar se pajtimi është i vështirë për të gjithë anëtarët e familjeve të viktimave, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Çdo kush ka të drejtë për respekt dhe kontributi i tyre në ndërtimin e besimit duhet të merret parasysh dhe të njihet.

net

09



Duhet t'i trajtojmë si prioritet proceset e ndërtimit të **besimit** dhe pajtimin.

Çka:

Njerëzit po mësohen gjithnjë e më shumë me jetët e tyre të izoluar. Sa më shumë kohë të kalojë pa besim dhe pajtim, aq më sfidues do të bëhet procesi dhe do të thellohen shkaqet kryesore të konfliktit, të cilat mund të kenë pasoja më afatgjata. Edhe pse mund të duket joreale të flitet për rivendosjen e besimit të ndërsjellë kaq shpejtë, komunitetet në Kosovë kanë jetuar për shumë vite në afërsi pa ndërveprim të vërtetë. Të gjitha komunitetet pajtohen se ka nevojë për paqe dhe se ekziston një predispozitë mjaft e mirë nga të gjithë që të paktën të jetojnë në një mjedis pa konflikte, duke pranuar të drejtën e njëri-tjetrit për të bashkëjetuar. Megjithatë, kjo pikëpamje mund të mos zgjasë përgjithmonë. Ka një lodhje dhe pakënaqësi gjithnjë e më të përhapur në lidhje me kohëzgjatjen e procesit të normalizimit politik të marrëdhënieve. Ekziston rreziku që çdo momentum dhe interes mund të humbet mes hapave sfidues që e përfshijnë procesin e besimit dhe të pajtimit..



Si:

Momenti është tani. Ne duhet t'i trajtojmë si prioritet proceset e ndërtimit të besimit dhe pajtimin. Ne duhet të vendosim masa mbrojtëse për t'i parandaluar ndërhyrjet politike, për t'i pranuar të gjitha pakicat, për t'u bashkuar rreth vlerave të përbashkëta, për t'i adresojmë e zgjidhim problemet dhe për të mbajtur komunikim të hapur. Këta janë hapat prioritarë të nevojshëm për ta ndërtuar besimin dhe për ta promovuar pajtimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme, në mënyrë që të arrihet një vizion i përbashkët i paqes, i cili mund të çojë në vendosjen e sigurisë dhe të prosperitetit për të gjithë.

net

10



Barabar
CENTRE